



REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË · OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Pranuar - Primjeto Më/Dana 17-07-2012			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednoet
01-013/	861		

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenin 15 dhe 16 lidhur me nenin 13 dhe 14 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr 2003/14 dhe në bazë të dispozitave të nenit 14 të Ligjit për ndryshimin e Ligjit për Planifikimin hapësinor nr 2003/14, Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për elementet themelore të Planit Rregullues Urban nr pr. 02/05 nr rendor 41 si dhe nenit 40.2 pika g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 2008/28, dhe nenit 35.2 pika g) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01- 013/491 të datës 21.04.2011, dhe mbështetur në kriteret e Planit Zhvillimor Urban të Komunës së Vitisë, të datës 28.12.2010 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 13.07.2012 aprovon këtë:

## V E N D I M

### SHPALLJEN E SHQYRTIMIT PUBLIK TË PLANIT RREGULLUES URBAN PËR ZONAT QENDRORE, JUGORE DHE LUMIT MORAVA

#### I.

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë LEJON shpalljen e shqyrtimit publik të Planit Rregullues Urban për zonat “Qendrore, Jugore dhe Lumit Morava “ të qytetit të Vitisë në mbështetje të Vendimit për hartimin e këtij plani nr. 01-013/332 të datës 17.03.2011.

#### II.

Të drejtë pjesëmarrje në shqyrtimin publik kanë të gjithë qytetarët e komunë, si dhe subjektet tjera të interesuara dhe të prekura nga procesi i hartimit dhe zbatimit të këtij plani.

#### III.

Shpallja e shqyrtimit publik të bëhet së paku në tri gazeta të përditshme dhe në mjete tjera të informimit së paku 8 ditë para shqyrtimit publik.

#### IV.

Pyetjet, vërejtjet sugjerimet, komentet (verbale dhe me shkrim) mund ti drejtohen ekipit për përcjelljen e shqyrtimit publik drejtpërdrejtë ose përmes Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Vitisë.

#### V.

Shqyrtimi publik do të organizohet në Shtëpinë e Kulturës “ Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, dhe do të zgjatë 30 ditë.

#### VI.


Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit .

#### VII.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi i dërgohet:

1. Drejtorisë për Urbanizëm,
2. Në dosje të Kuvendit
3. Arkivit



KRYESUESI I KUVENDIT  
Skenderbe Hebib

*Skenderbe Hebib*